

INFORMACION BAZË MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Përgjegjëse për trajtimin e tyre: ITX MERKEN, B.V.

Qëllimi dhe baza e ligjësimit: nëse je dakord, do të publikojmë fotografinë tënde dhe disa të dhëna personale (p.sh. emrin e përdoruesit të rrjetit social) në faqet web të vendeve në të cilat operon BERSHKA. Motivi për të cilin jemi të ligjësuar për të përdorur të dhënat e tua është **pëlqimi** që na jep duke iu përgjigjur mesazhit që të kemi dërguar me hashtagun #yesbershka.

Marrësit e të dhënave: të dhënat e tua i ndajmë me ndërmarrjet dhe bashkëpunëtorët që na e ofrojnë këtë shërbim brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian, të cilët na mbështesin në dërgimin e informacionit dhe e bëjmë me garancitë e duhura dhe duke ruajtur sigurinë e të dhënave të tua.

Të drejtat: mund të tërheqësh pëlqimin e dhënë në çdo moment dhe pa asnjë kosto dhe, përveç kësaj, të ushtrosh të drejtat e tjera siç shpjegohet në klauzolat 8 dhe 11 të këtij dokumenti.

Informacion shtesë: për më tepër informacion, konsulto klauzolën 8 të këtij dokumenti dhe Politikën e Privacitetit të BERSHKA e disponueshme në www.bershka.com.

TERMAT DHE KUSHTET

Termt dhe Kushtet e mëposhtme rregullojnë hyrjen, lundrimin dhe përdorimin e kësaj Galerie.

ITX MERKEN, B.V., një kompani holandeze me seli në Amsterdam, Nieuwezijds Voorburgwal 307, 1012 RM, me numër identifikimi tatimor NL 855820627B01, përmes markës BERSHKA (në tekstin e mëtejshëm, "BERSHKA"), u ofron përdoruesve mundësinë e dhënies së imazheve, komenteve, videove dhe përmbajtjeve të tjera (në tekstin e mëtejshëm, "Përmbajtja") përmes seksioneve përkatëse të faqes në internet, aplikacionit celular, profileve në rrjetet sociale, mediave digjitale, buletineve informative ose pajisjeve të aktivizuara për të ndërvepruar me platformën e shitjeve në internet për produkte, shërbime dhe funksionalitete që lidhen me markën BERSHKA (në tekstin e mëtejshëm, "Shërbimet").

1. Termt dhe Kushtet e pranimit

1.1 Hyrja, lundrimi dhe përdorimi i Shërbimeve është përgjegjësi e përdoruesve siç parashikohet në këto Termt dhe Kushte.

1.2 Aty ku është e mundur, lidhjet për te faqet e tjera të internetit dhe materialet dhe/ose përmbajtja e palëve të treta, ofrohen vetëm për qëllime informative, pa pasur asnjë kontroll mbi përmbajtjen e tyre. Prandaj ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi për ndonjë dëm ose humbje që rrjedh nga ato

1.3 Publikimi i përmbajtjes iu nënshtrohet këtyre kushteve të përgjithshme. Ju duhet të lexoni dhe të pranoni këto Termt dhe Kushte para se të përdorni Shërbimet. Nëse nuk jeni dakord me Termt dhe Kushtet, ju lutemi të mos përdorni Shërbimet.

1.4 Përdorimi i këtyre shërbimeve nuk përbën asnjë lloj marrëdhënieje kontraktuale mes juve dhe BERSHKA.

2. Funksionimi i Shërbimeve

2.1 Përmbajtja duhet të tregojë (i) veshje apo aksesore BERSHKA ose (ii) njerëz që kanë veshur të paktën dy (2) veshje apo aksesore kryesore BERSHKA (me veshje kryesore nënkuptohen, pantallonat, fustanet, fundet, palltot, xhaketat, këmbisat, bluzat, etj., dhe si aksesore kryesore, çantat, këpucët, syzet e diellit, shamitë, etj.). Ju duhet t'i trajtoni veshjet dhe/ aksesorët e lartpërmendur, si dhe të publikoni përmbajtjen, në mënyrë të kujdesshme dhe korrekte, duke shmangur në çdo kohë dëmtimin, cenimin ose dëmtimin në ndonjë mënyrë tjetër të këtyre veshjeve dhe / aksesoreve, në BERSHKA ose markën "BERSHKA".

2.2 BERSHKA rezervon të drejtën të zgjedhë përmbajtjen që ju publikoni në çdo rrjet social të lidhur me universin BERSHKA. Nëse publikoni përmbajtjet në rrjetet sociale Facebook, TikTok dhe/ose Instagram, duhet të përmendni shprehimisht llogarinë zyrtare të Bershka: @bershka dhe/ose të përfshini hashtagun #bershkastyle. Në çdo rast, BERSHKA do të kërkojë lejen tuaj për të publikuar këtë Përmbajtje nëpërmjet hashtagut #yesbershka, që kërkon leximin dhe pranimin paraprak të Termave dhe Kushteve të përmendura.

2.3 Përmbajtja që ju na ofroni, ose në mënyrë direkte, ose ajo për të cilën BERSHKA kërkon autorizimin tuaj, do zgjidhet me kujdes nga ana jonë, pa qenë të detyruar të përdorim të gjithë Përmbajtjen e përcjellë apo një pjesë të saj. BERSHKA ka të rezervuar të drejtën të shtojë apo të fshijë tekstin, si edhe të redaktojë materialet grafike dhe të mos pranojë, të pezullojë, të anulojë, apo të eliminojë publikimin e Përmbajtjes tuaj.

2.4 Në rast se Përmbajtja që keni publikuar ose keni vendosur në dispozicionin tonë zgjidhet, kjo do të thotë që Përmbajtja do tregohet ose do shfaqet në faqen web, në aplikacionin e celularit, në profilet zyrtare në rrjetet sociale, në newsletter-at që dërgohen sipas rastit dhe në suportet digjitale dhe fizike ose në materiale të tjera promovionale të vendosura apo që lidhen me shitjen e produkteve të markës BERSHKA nëpërmjet pikave të shitjes së BERSHKA (që këtej e tutje, "Mediat").

2.5 Meqë përdorimi i Shërbimeve nënkupton që Përmbajtja do të tregohet apo do të shfaqet në profilet zyrtare të BERSHKA, ju rekomandojmë që të lexoni hollësisht Kushtet e Përdorimit të këtyre rrjeteve sociale, tek të cilat mund të aksesoni nëpërmjet tyre.

2.6 Meqë përdorues të tjerë mund të shohin dhe të kenë akses në Përmbajtje, ata mund të zgjedhin ta ndajnë atë nëpërmjet platformave të duhura, duke përdorur opsionet e disponueshme për këtë qëllim në përputhje me Kushtet e cituara në platformat në fjalë. Rrjedhimisht, ju pranoni dhe jepni pëlqimin shprehimisht, nëpërmjet përdorimit të Shërbimeve, që Përmbajtja që është publikuar dhe është vënë në dispozicion të BERSHKA, të ndahet, sipas rastit, me pjesën tjetër të përdoruesve të këtyre platformave.

2.7 Në data të caktuara dhe në tregje konkrete, publikimi i Përmbajtjes, me përdorimin pasues të Shërbimeve dhe pranimin e shprehur të Termave dhe Kushteve, mund të çojë në pjesëmarrje në një konkurs, bazat ligjore të të cilit (në rast se janë në fuqi) i bashkëngjiten këtij dokumenti si Aneksi 1.

3. Moshë madhore

Aksesimi dhe përdorimi i Shërbimeve u rezervohet atyre mbi 18 vjeç dhe ndalohet rreptësisht përfshirja e atyre nën 18 vjeç në Përmbajtje. Duke pranuar këto kushte të përgjithshme, ju deklaroni se jeni mbi 18 vjeç, se keni aftësinë ligjore për të lidhur kontrata dhe se jeni plotësisht përgjegjës për atë deklaratë.

4. Modifikimi i Termave dhe Kushteve

BERSHKA rezervon shprehimisht të drejtën për të modifikuar këto Terma dhe Kushte pa lajmërim paraprak. Ndryshimet e paraqitura nuk do të jenë prapavepruese. Ju njihni dhe pranoni që është përgjegjësia juaj të kontrolloni Shërbimet dhe këto Terma dhe Kushte. Përdorimi i vazhdueshëm nga ana juaj i këtyre Shërbimeve pas këtyre modifikimeve do të merret si pranim i modifikimeve të Termave dhe Kushteve dhe ju do keni detyrim ndaj Termave dhe Kushteve të reja.

5. Përdorimi korrekt i shërbimeve dhe kufizimet e përdorimit

5.1 Më poshtë ju garantoni dhe angazhoheni që:

- Përmbajtja që ju na dërgoni (i) nuk tregon foton e një të treti apo të tretëve të ndryshëm nga ju, pa pasur pëlqimin e të tredit apo të tretëve në fjalë; (ii) nuk riprodhon asnjë vepër të krijuar nga të tretët, pa pasur pëlqimin e të tretëve në fjalë; (iii) nuk riprodhon produktet, markat, emrat komerciale apo të tjera të drejta të pronësisë industriale të të tretëve, pa pasur pëlqimin e këtyre të fundit; dhe (iv) nuk tregon apo riprodhon një imazh i mituri, me përjashtim të rastit kur Përmbajtja përkatëse paraqitet nga babai, nëna, tutori apo përfaqësuesi ligjor i fëmijës.

- Përmbajtja që na dërgoni, nuk shkel të drejtat (përfshirë, si shembull, të drejtat e pronësisë intelektuale, të pronësisë industriale, apo të drejtën për imazhin dhe intimitetin personal, apo çdo lloj tjetër të drejte) apo interesat e të tretëve dhe asnjë standard apo normativë të aplikueshme (ndërkombëtare, spanyolle apo ndonjë tjetër).

- Përmbajtja që ju na ofroni nuk ka asnjë element që mund të konsiderohet ofendues apo diskriminues (për arsye race, feje, gjinie, orientimi seksual, përkatësie politike apo sindikale), ilegal, kërcënues, shpifës, përgojues, i turpshëm, pornografik, i pahijshëm apo i papërshtatshëm në çdo rast; nuk përbën apo nxit një sjellje që mund të konsiderohet si e kundërt me ligjin; nuk përmban asnjë element të papërshtatshëm apo në kundërshti me zakonet e mira dhe rendin publik; nuk ka për qëllim të bezdisë përdoruesit e tjerë dhe komentet të cilat mund të shoqërojnë Përmbajtjen nuk janë përgojuese apo përcmuese ndaj BERSHKA apo ndaj çdo marke tjetër të Grupit Inditex, vetë Grupit Inditex apo ndaj ndonjë të treti.

- Përmbajtja nuk përbën apo përmban asnjë virus informatik, krimb, virus trojan, kërkese komerciale, letra zinxhir, e-maile masive ose çdo formë tjetër komunikimi spam apo çdo lloj elementi tjetër infektues, që përfshin, pa kufi, kode apo skedarë të ekzekutueshëm që mund të përdoren apo përdoren për të aksesuar, modifikuar, fshirë apo dëmtuar sistemin ose pajisjet informatike (software dhe hardware) të BERSHKA dhe të të tretëve, apo dokumentet elektronikë dhe skedarët e ruajtur në atë sistem ose në pajisjet informatike.

6. Kufizimi i garancive dhe i përgjegjësisë

6.1 Ju pranoni shprehimisht që përdorimi që u bëni Shërbimeve është përgjegjësi e plotë juaja.

6.2 BERSHKA nuk mban përgjegjësi për çdo përmbajtje të krijuar, publikuar dhe vënë në dispozicion nga përdoruesit, me përjashtim të rasteve të detyruara me ligj.

6.3 Gjithashtu, përmbajtja që del në Media mund të përfshijë opinione, deklarata dhe përmbajtje tjetër të të tretëve. Pavarësisht se Bershka angazhohet të bëjë më të mirën për të garantuar cilësinë e Shërbimeve dhe për të shmangur çdo gabim apo pasaktësi në Përmbajtje, ne nuk jemi përgjegjës për informacionin e publikuar nga këto Media, si edhe për ato opinione, komente, vlerësime apo çdo gjë tjetër që ato pasqyrojnë e që nuk është përcjellë direkt nga BERSHKA. Gjithashtu, ne nuk jemi përgjegjës për kontrollimin, monitorimin apo verifikimin e kësaj përmbajtje as për saktësinë dhe besueshmërinë e saj, apo për të garantuar që veprohet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm. Opinione, deklaratat dhe materiale të tjera vënë në dispozicion nga të tretët nuk i përkasin BERSHKA, por këtyre të tretëve dhe BERSHKA nuk i mbështet këto opinione, deklarata apo materiale.

Personi i identifikuar në çdo rast si autori i Përmbajtjes në fjalë është përgjegjës për të. Ju njihni dhe pranoni që ne nuk kemi asnjë kontroll, dhe nuk do të marrim asnjë përgjegjësi për dëme të mundshme direkte, indirekte, për incidentet që mund të krijohen apo pasojat që mund të ketë përdorimi apo abuzimi nga ana e të tretëve me informacionin që shfaqet në Media.

6.4 Në lidhje me këtë, BERSHKA nuk bëhet përgjegjëse për Përmbajtje dërguar nga përdoruesi kur nuk ka njohuri reale që informacioni i ruajtur është i jashtëligjshëm apo që prek pasuri e të drejta të një të treti për të cilat këtij i lind e drejta të kërkojë dëmshpërblim. Në momentin që Bershka mëson që po ruan të dhëna si ato që u përmendën më sipër, angazhohet të veprojë menjëherë për t'i hequr apo për ta bërë të pamundur aksesimin e tyre.

6.5 Gjithashtu, BERSHKA rezervon të drejtën të largojë në mënyrë unilaterale Përmbajtje të ruajtura në cilëndo nga Mediat, kur çmon që ajo bie në kundërshtim me këto Terma dhe Kushte, kur ka të dhëna që Përmbajtja shkel çdo dispozitë ligjore, shkel të drejtat e të tretëve, konsiderohet e dëshme apo përdoret për qëllime reklame (spam), si edhe në rastin kur BERSHKA e gjykon me vend të veprojë kështu.

6.6 BERSHKA rezervon të drejtën të ndërpresë Shërbimet për riparime teknike dhe mirëmbajtje të pajisjeve, si edhe për përmirësim të vetë Shërbimeve.

6.7 Në çdo rast, garantohen të gjitha të drejtat që Ligjet në fuqi u garantojnë përdoruesve.

7. Pronësia Intelktuale dhe Industriale dhe kalimi i të drejtave të tretëve

7.1 **Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale** mbi elementët e Galerisë, duke kuptuar si të tillë për shembull, tekstet, fotografitë, grafikët, imazhet, ikonat, teknologjinë, software-in, linket dhe përmbajtje të tjera audiovizuale dhe me zë, si edhe dizajnon e saj grafike dhe kodet burimore (duke përfshirë Përmbajtjen e përdoruesve) **janë pronësi e BERSHKA** ose e përfituesve të saj dhe nuk konsiderohen si të transmetuara tek përdoruesi asnjë nga të drejtat e shfrytëzimit të njohura nga normativa në fuqi.

7.2 Si **publikimi i përmbajtjes nga ana juaj në galeri** ashtu edhe vënia në dispozicion e përmbajtjes për përdorim në galeri dhe/ose media, nënkupton dhënien BERSHKA-s një **licencë falas dhe mbarëbotërore**, për **afatin maksimal** të mbrojtjes së parashikuar nga ligji dhe me fuqinë për t'u transferuar palëve të treta, mbi të gjitha të drejtat e shfrytëzimit (pronësisë intelektuale dhe industriale, si dhe të drejtat mbi imazhin, emrin ose emrin e përdoruesit të rrjetit social, fotografinë e profilit të çdo natyre tjetër), duke përfshirë **të drejtat e riprodhimit, shpërndarjes, komunikimit publik, transformimit dhe vënies në dispozicion**, për të gjitha përmbajtjet e lartpërmendura, për qëllime të **shfrytëzimit të tyre tregtar dhe/ose për qëllime reklamimi**, drejtpërdrejt ose nëpërmjet palëve të treta, në dhe/ose nëpërmjet të gjitha mbështetëjeve, mediave, formateve dhe formave të shfrytëzimit, shpërndarjes, komunikimit publik ose shpërndarjes, të njohura aktualisht ose që do të ekzistojnë në të ardhmen, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, sa vijon:

(a) Rrjetet e telekomunikacionit: nëpërmjet përdorimit të përmbajtjes në çdo rrjet komunikimi global dhe/ose transmetimi digjital të dhënave (me kablo, pa tel ose çdo lloj tjetër) si për shembull, rrjetet e telefonisë celulare ose interneti, i cili përfshin si sajtet, ashtu edhe faqet e internetit të zotëruara ose të kontrolluara, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga Bershka dhe/ose Grupi Inditex, si dhe çdo faqe tjetër interneti (për shembull, pa u kufizuar në, www.tmall.com, www.asos.com, www.vente-privee.com, www.privalia.com, www.ssg.com, www.zalando.com, www.trendyol.com, www.wildberries.ru etj.), faqe e ndërveprimit social, blog, profil personal ose të ngjashme, pavarësisht nëse janë apo jo nën kontrollin e Bershka dhe/ose Grupit Inditex, si dhe nëpërmjet përdorimit të përmbajtjes për reklamim në dhe/ose përmes mediave digjitale si banderolat, buletinet informative ose hapësira të tjera reklamimi në internet.

(b) Pikat e shitjes, të etiketimit dhe suporteve dixhitale: nëpërmjet përfshirjes totale ose të pjesshme të Përmbajtjes nga ana e Bershkës apo çdo të treti të autorizuar nga kjo në ekrane, ekrane të TV apo kompjuterit dhe dispozitivë të ngjashëm, në katalogë, broshura, afishime, prezantime, kopertina, vende ekspozimi, projektorë, vitrina, poster, si brenda ashtu edhe jashtë gjithë pikave të shitjes dhe qendrave komerciale dhe ndërtesave ku përfshihen pikat e shitjes, në etiketa dhe suportet dixhitale apo materiale të tjera promociionale fiksuar apo lidhur me shitjen e Produkteve nëpërmjet Pikave të Shitjes.

(c) Të tjera: nëpërmjet përfshirjes të Përmbajtjes (me qëllime informative apo çdo lloj qëllimi tjetër legjitim), nga ana e Bershka apo çdo të treti të autorizuar nga kjo, në lajme apo reportazhe të publikuara në gazeta, revista apo në çdo lloj tjetër publikimi dhe media të shkruar apo digjitale.

Për ta shpjeguar saktësisht, në bazë të sa u tha më sipër, ndërmjet përdorimeve të tjera të mundshme, Bershka, direkt apo nëpërmjet të tretëve, është e autorizuar të: (1) ofrojë në faqet web të Pikave të Shitjes, ndërmjet tyre dhe faqja web www.bershka.com, opsione (të tilla si opsioni “ndaj në”) nëpërmjet të cilave përdoruesit e Internetit mund të riprodhojnë, ndajnë, apo përcjellin linkun direkt të Përmbajtjes në hapësirat apo faqet që këta përdorues mund të kenë në rrjetet sociale (si për shembull, “YouTube”, “Facebook”, “Instagram” o “Flickr”) dhe shërbime të ngjashme të ndërveprimit social online dhe (2) **të lejojë shkarkimin** për qëllime private të Përmbajtjes nga ana e këtyre përdoruesve të Internetit.

8. Mbrojtja e të dhënave

Përdoruesit japin pëlqimin që të dhënat personale, përfshirë dhe ato që mund të përfitohen nga Përmbajtja (bashkarisht, “**Të dhënat**”) të cilat bëhen të ditura nëpërmjet kanaleve të ndryshme vënë në dispozicion të përdoruesve, do të trajtohen nga ITX MERKEN, B.V. që ka përgjegjësinë t’i ndajë ato nëpërmjet Internetit, duke përfshirë, ndërmjet të tjerave, faqet web të vendeve në të cilat operon BERSHKA, rrjetet sociale si edhe lloje të tjera kanalesh komunikimi të përdorura për njohjen e markës.

Për të përmbushur qëllimin e sipërpërmendur, është e domosdoshme që t’u japim akses në të dhënat e përdoruesve firmave të Grupit Inditex (për shembull, shoqërive përgjegjëse për faqet web të vendeve në të cilat BERSHKA operon ose shoqërisë që vepron si mëmë e markës Bershka në Spanjë) dhe palëve të treta që na ofrojnë mbështetje në shërbimet që ofrojmë, siç janë shërbimet teknologjike apo shërbimet e krijimit të përmbajtjes për përdoruesit. Për një shërbim më eficient, disa nga shoqëritë e përmendura janë vendosur në territore që ndodhen jashtë Bashkimit Evropian siç janë Shtetet e Bashkuara, që nuk na ofrojnë një nivel mbrojtës të dhënash të njëjtë me atë të Bashkimit Evropian. Në këtë rast, i informojmë përdoruesit që i transferojmë të dhënat e tyre me **garancitë e duhura dhe duke i ruajtur ato gjithmonë të sigurt**. Me këto firma kemi firmosur **Klauzola Kontraktuale Standarte** të aprovuara nga Komisioni, përmbajtja e të cilave mund të konsultohet në linkun e mëposhtëm: [Standard contractual clauses for international transfers | European Commission \(europa.eu\)](http://Standard%20contractual%20clauses%20for%20international%20transfers%20-%20European%20Commission%20(europa.eu))
Të dhënat tuaja do ruhen për sa kohë Shërbimi është në fuqi dhe përdoruesi nuk e heq pëlqimin e dhënë.

Përdoruesi mund të ushtrojë në çdo moment të drejtat e tij të aksesimit, korigjimit, heqjes, kufizimit të trajtimit dhe transferimit të të dhënave, duke dërguar një komunikim me shkrim në adresën e e-mailit dataprotection@bershka.com dhe duke shkruar “Imagen” dhe vendin përkatës në temën e e-mailit. Në rast se del e nevojshme, mundo t’ju kërkojmë informacion shtesë për t’ju identifikuar si përdorues.

Në rast se pasi të keni dhënë pëlqimin tuaj dëshironi ta revokoni atë, mund ta bëni këtë duke dërguar një email në IM@bershka.com dhe duke përshkruar qëllimin e kërkesës suaj, siç shpjegohet në pikën 11 të këtyre kushteve të përgjithshme. Gjithashtu, përdoruesi mund të kërkojë në çdo moment që Përmbajtja e tij të hiqet siç shpjegohet në pikat 11 dhe 12 të këtyre Termave dhe Kushteve.

Së fundmi, ju informojmë që mund të kontaktoni me të Deleguarën e Mbrojtjes së të Dhënave për çdo konsultë lidhur me mbrojtjen e të dhënave duke dërguar një e-mail në adresën dataprotection@bershka.com dhe ju informojmë mbi të drejtën tuaj për të **paraqitur** një ankesë pranë **autoritetit të kontrollit** përsa i përket mbrojtjes së duhur të të dhënave: http://ec.europa.eu/justice/article-29/structure/data-protection-authorities/index_en.htm

Për më shumë informacion mbi përdorimin e të dhënave të tua, konsulto politikën e privacitetit të Bershkës që mund ta gesh në në www.bershka.com

9. Konfidencialiteti

Gjatë periudhës së qëndrimit në fuqi të këtyre Kushteve dhe Termave dhe gjatë një periudhe prej dy (2) vjetësh që prej përfundimit të tyre, asnjëra nga palët nuk mund t'i zbulojë Informacionet Konfidenciale të palës tjetër një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës në fjalë. Nuk përfshihet informacioni që është bërë publikisht i njohur pa përbërë shkelje për asnjërin nga palët ose që është (i) zhvilluar në mënyrë të pavarur pa akses në "Informacionin Konfidencial" të palës tjetër; (ii) i marrë në mënyrë të jashtëligjshme nga një i tretë; ose (iii) kur urdhërohet me ligj të zbulohet për shkak të një kërkesë gjyqësore ose nga autoriteti kompetent. Për këto qëllime, me informacion konfidencial do të nënkuptohet çdo informacion i çdo natyre dhe në çdo formë, format ose medium në lidhje me BERSHKA, çdo kompani të Grupit Inditex ose vetë Grupit Inditex, ose me palën tjetër, pavarësisht nëse informacioni i përmendur identifikohet apo klasifikohet si konfidencial apo jo.

10. Denoncimi i abuzimeve

Nëse mendoni se ndonjë nga përmbajtjet e disponueshme në media është fyese, e papërshtatshme dhe/ose cenon të drejtat tuaja të njohura në rregulloret aktuale, ju mund ta raportoni përmbajtjen duke na kontaktuar në adresën e emailit contact@bershka.com.

Në vazhdim, BERSHKA mund të hetojë mbi vërtetësinë dhe orgjinën e kërkesës suaj dhe të kontrollojë materialin në fjalë, duke ju kontaktuar me e-mail nëse do ishte e nevojshme dhe duke e mbajtur përmbajtjen të hequr në rast se kërkesa juaj pranohet ose duke e ripranuar dhe shfaqur atë sërish nëse kërkesa juaj hidhet poshtë, gjithmonë nëse autori nuk e ka fshirë nga rrjetet sociale.

FSë fundmi, nëse dëshironi, për çdo ankesë lidhur me përmbajtjen e publikuar në Media mund të drejtoheni në adresën e e-mailit contact@bershka.com. Në këtë rast, BERSHKA do vijojë me hetimin e vërtetësisë dhe orgjinës së kërkesës suaj dhe do kontrollojë materialin në fjalë.

11. Heqja e përmbajtjes

Ju mund të kërkonte fshirjen e përmbajtjes së krijuar nga ju duke dërguar një email në IM@bershka.com dhe duke përshkruar qëllimin e kërkesës suaj. Ju informojmë që do përdorim adresën tuaj të e-mailit vetëm në rastin kur për të plotësuar kërkesën tuaj do të na lindë e nevojshme të kontaktojmë me ju.

Heqja e përmbajtjes do të bëhet në mënyrë automatike që prej marrjes dhe përpunimit të kërkesës suaj, edhe pse materiali mund të jetë akoma i dukshëm në vazhdim për rreth 24 orë. Pa prekur ç'ka u tha më sipër, Përmbajtja që gjendej tashmë në dispozicion të publikut në çdo lloj rrjeti social si pasojë e përdorimit të Përmbajtjes në rrjetin social në fjalë përgjatë kohës që përfshin pëlqimin dhe kërkesën e duhur të heqjes së Përmbajtjes mund të qëndrojë gjithmonë në këtë situatë, edhe pse në asnjë rast kjo përmbajtje nuk mund të ripërdoret.

12. Çregjistrimi nga Shërbimet

Nëse dëshironi që përmbajtja e krijuar nga ju të mos dorëzohet për shqyrtim dhe publikim nga BERSHKA, duhet (i) të ndaloni ngarkimin e përmbajtjeve të përmendura shprehimisht në llogarinë zyrtare të Bershka: [@bershka](https://www.instagram.com/bershka) ose duke përdorur hashtagun [#bershkastyle](https://www.instagram.com/bershkastyle) dhe (ii) të dërgoni një email me kërkesën tuaj në IM@bershka.com. Pas marrjes së komunikimit, BERSHKA do të ndalojë së vlerësuar përzgjedhjen e përmbajtjes suaj.

13. Juridiksioni dhe ligji i aplikueshëm

Të gjitha problemet që lindin midis BERSHKA-s dhe jush në lidhje me interpretimin, pajtueshmërinë dhe vlefshmërinë e kushteve të përgjithshme, do të rregullohen nga klauzolat e tyre dhe, për aq sa nuk parashikohen, në përputhje me legjislacionin spanjoll, ku palët i nënshtrohen shprehimit juridiksionit joekskluziv të gjykatave dhe gjyqeve spanjolle.